

2022

MANUAL PRAKTIK  
**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË  
DHE QASJEN NË DREJTËSI**



Alternative Dispute Resolution Center  
Mediation Center Mitrovica



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

## Manual Praktik për Sistemin e Drejtësisë dhe Qasjen në Drejtësi

Autor:

Dr. sc. Isuf Jahmurataj

Editor/e:

Zana Sylja

Besnik Uka

Publikuar në kuadër të projektit *“Drejt lehtësimin të qasjes në drejtësi në veri të Kosovës”* nga:



Alternative Dispute Resolution Center  
Mediation Center Mitrovica

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (“ADRC”) është organizatë jo-qeveritare me qendër në Mitrovicë, puna e së cilës është e përqendruar në ofrimin e një platforme për angazhim të përbashkët ndëretnik dhe mirëkuptim të ndërsjellë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe paqes dhe zhvillimin e komuniteteve në rajonin e Mitrovicës. ADRC gjithashtu është e specializuar në fushën e ndërmjetësimit dhe ka mbështetur dhe mbështet fuqizimin e sistemit të drejtësisë në veçanti në rajonin e Mitrovicës, por dhe më gjërë.

Mbështetur nga:



Përmbajtja e këtij publikimi mbetet përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton apo përfaqëson në asnjë mënyrë pikëpamjet e National Endowment for Democracy (“NED”) apo të institucioneve të drejtësisë të referuara në këtë material. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në ndonjë formë dhe/apo mënyrë pa lejen e publikuesit.

*Mitrovicë, nëntor 2022*

## PËRMBAJTJA

---

HYRJE.....	1
1. TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE DHE SISTEMI I DREJTËSISË.....	3
2. GJYKATA THEMELORE DHE QASJA NË DREJTËSI.....	4
2.1. Gjykata Themelore.....	4
2.2. Qasja në Gjykatën Themelore.....	6
2.3. Skema praktike e qasjes në Gjykatën Themelore në marrëdhëniet juridiko-civile.....	8
3. GJYKATA E APELIT DHE QASJA NË DREJTËSI.....	9
3.1. Gjykata e Apelit.....	9
3.2. Qasja në Gjykatën e Apelit.....	9
4. GJYKATA SUPREME DHE QASJA NË DREJTËSI.....	11
4.1. Gjykata Supreme.....	11
4.2. Qasja në Gjykatën Supreme.....	11
5. SISTEMI PROKURORIAL DHE QASJA NË DREJTËSI.....	12
5.1. Prokuroria Themelore.....	12
5.2. Qasja në Prokurorinë Themelore.....	13
5.3. Skema praktike e qasjes në Prokurorinë Themelore.....	14
5.4. Prokuroria e Apelit.....	15
5.5. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.....	15
5.6. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.....	15
6. MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR DREJTËSINË.....	16
7. SISTEMI I AVOKATISË DHE QASJA NË AVOKAT.....	17
8. INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT DHE QASJA NË DREJTËSI.....	18
9. NDIHMA JURIDIKE FALAS DHE QASJA NË DREJTËSI.....	19
9.1. Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas.....	19

9.2. Qasja në Ndhimën Juridike Falas .....	20
10. NDËRMJETËSIMI DHE QASJA NË DREJTËSI.....	21
10.1. Procedura e ndërmjetësimit.....	21
10.2. Qasja në procedurën e ndërmjetësimit .....	22
11. NOTERIA DHE QASJA NË DREJTËSI.....	24
12. PËRMBARIMI DHE QASJA NË DREJTËSI.....	26
13. LISTA E BURIMEVE NË FORMË TË SHTOJCËS.....	31

## SHKURTESAT

ADRC Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve

---

ANJF Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas

---

IAP Institucioni i Avokatit të Popullit

---

KGJK Këshilli Gjyqësor i Kosovës

---

KPK Këshilli Prokurorial i Kosovës

---

MD Ministria e Drejtësisë

---

NED National Endowment for Democracy

---

OAK Oda e Avokatëve të Kosovës

---

ONDK Oda e Ndërmjetësuesëve të Republikës së Kosovës

---

OPK Oda e Përmbaaruesve Privat të Kosovës

---

MCM Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë

---

ZMNV Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

## HYRJE

---

Njeriut me ekzistencën e tij apo saj i linden dhe përkasin të drejta të cilat i ka për vetë faktin se është njeri dhe të cilat duhet t'i sigurojë shteti përmes sistemit juridik, ekonomik, arsimor, social, politik, etj. Këto të drejta të cilat janë universale dhe përfshijnë një gamë të gjerë të tyre që synojnë të njohin vlerën, dinjitetin, barazinë dhe interesat e qenies njerëzore (duke përfshirë marrëdhëniet ndër-njerëzore dhe jeta e përbashkët në shoqëri) rregullohen përmes normave juridike.

Pavarësisht faktit se ekzistojnë këto norma juridike, njeriu përballet me situata ku të drejtat që ka mund të cenohen, shkelen apo mohohen nga një individ, njësi tjetër apo vetë organe të shtetit. Në këto situata dhe me qëllim të mbrojtjes së të drejtave nga të tjerët përfshirë rregullimin e marrëdhënieve njerëzore, atëherë sistemi juridik ofron mundësinë e mbrojtjes ligjore. Kjo mundëson që njeriu ato të drejta që i posedon si rrjedhojë e vetë ekzistencës së tij/saj e të cilat që shoqëria i ka rregulluar si marrëdhënie, në rastet kur cenohen apo shqetësohen, t'i mbroj përmes garantimit të qasjes në drejtësi dhe sistemit të drejtësisë. Në Republikën e Kosovës këto janë të rregulluara dhe garantuara me Kushtetutë dhe ligjet tjera përkatëse.

**Sistemi i drejtësisë** është një term i gjerë që përfshin kornizën ligjore dhe atë institucionale që i referohet gjykatave, prokurorisë dhe sistemit të shërbimit korrektues dhe atij sprovues, gjithashtu dhe mekanizmave si avokatia, ndihma juridike falas, ndërmjetësimi, etj.<sup>1</sup> Në anën tjetër, **sistemi gjyqësor** përfshin kornizën ligjore dhe atë institucionale që i referohet si pikë e parë gjykatave.<sup>2</sup> Ndërsa, **qasja në drejtësi** mund të definohet si mundësia dhe aftësia e njerëzve për të "kërkuar dhe arritur zgjidhje përmes institucioneve formale ose jo-formale [p.sh., si ndërmjetësimi] të drejtësisë në lidhje me shqetësimet dhe ankesat që kanë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut."<sup>3</sup> Si e tillë përfshin një kornizë ligjore mbrojtëse, qasjen në institucionet gjyqësore, garantimin e përfaqësimit ligjor, ndihmën juridike, qasjen në informacion dhe ndërgjegjësim mbi qasjen në drejtësi dhe po ashtu bashkëpunimin dhe monitorimin nga ana e shoqërisë civile.<sup>4</sup> Qasja në drejtësi ndër të tjera varet edhe nga informacioni që njerëzit kanë dhe njohja e të drejtave të tyre dhe i mekanizmave që shërbejnë për t'i realizuar dhe mbrojtur këto të drejta në mënyrë efektive dhe të përballueshme.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> Task Forca për Integrimin Europian, *MATERIAL DISKUTUES MBI SISTEMIN E DREJTËSISË NË KOSOVË* (Tryezë Tematike e Rrumbullakët "Drejtësia, Liria dhe Siguria") f 2.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara, "Kusht i Domosdoshëm: Qasja në Drejtësi" (*USIP*) <[<sup>4</sup> Po aty.](https://www.usip.org/guiding-principles-stabilization-and-reconstruction-the-web-version/rule-laë/access-justice#:~:text=Access%20to%20justice%20involves%20normative,resolving%20personal%20and%20political%20disputes.></a> qasur më 23 gusht 2022.</p></div><div data-bbox=)

<sup>5</sup> Charles P Sabatino, "Qasja në Drejtësi: Parimi i Popullit" (2019-20) 43(4) ASA 6, f 6.

Ky manual ka për qëllim që të kontribuoj në këtë drejtim dhe të pajisë lexuesin e përgjithshëm me informacione dhe njohuri efektive dhe praktike për një numër të drejta që ka, sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës dhe qasjen në drejtësi.

“Manuali Praktik për Sistemin e Drejtësisë dhe Qasjen në Drejtësi” fillon me trajtimin e disa nga të drejtat dhe liritë themelore të ndërlidhura me sistemin e drejtësisë dhe qasjen në drejtësi, për të vazhduar më pas me trajtimin e **Gjykatës Themelore dhe qasjes në të**. Me shumë kujdes është trajtuar edhe akti përkatës juridik përkatësisht *padia*, me të cilin mund të qaset Gjykata Themelore. Përveç nivelit themelor apo të shkallës së parë, manuali gjithashtu përfshin të dhëna mbi **Gjykatën e Apelit**, për faktin se është porta tjetër që qytetarët mund të qasin për të parashtruar ankesë kundër vendimeve të Gjykatës Themelore apo të shkallës së parë. Në Republikën e Kosovës, **Gjykata Supreme** është gjykata më e lartë në kuadër të sistemit gjyqësor dhe si e tillë zë një pjesë të rëndësishme në kuadër të manualit. Në përfundim të këtyre pjesëve, qytetari do të ketë të njohur qasjen nga gjykatat e shkallës së parë e deri tek ajo më e lartë.

Në kuadër të manualit, gjithashtu diskutohet edhe **sistemi prokurorial i Republikës së Kosovës** dhe qasja dhe mënyra e qasjes apo akti juridik me të cilin qytetari komunikon me të me rastin e paraqitjes së një shkeljeje, përkatësisht vepre penale nga e cila është dëmtuar.

Pjesë tjetër me rëndësi është edhe ajo që i referohet **IAP-së** si mekanizëm kushtetues në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe **Ndihmës Juridike Falas** e cila ju mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

Një hapësirë e manualit po ashtu i është dedikuar edhe Profesioneve të Lira dhe më konkretisht në manual trajtohen **Avokatia, Ndërmjetësimi, Noteria dhe Përmbarimi Privat**. Duke u nisur nga fakti se profesionet e lira ushtrojnë autorizime publike në fushën e drejtësisë, këto mundësojnë qasjen në drejtësi, andaj dhe trajtimi i tyre.

Manuali është përgatitur dhe publikohet në kuadër të projektit **“Drejt lehtësimit të qasjes në drejtësi në veri të Kosovës”** të implementuar nga ADRC (të njohur si MCM)<sup>6</sup> dhe të mbështetur nga NED. Qëllimi i projektit është që të lehtësoj qasjen në drejtësi të komuniteteve jo-shumicë (komuniteteve pakicë) dhe një integrim më të arrirë gjyqësor në Kosovë. Ndërsa, qëllimi specifik i manualit është që të ngrisë dhe avancojë vetëdijen dhe ndërgjegjësimin qytetar juridik dhe të kontribuoj drejt qasjes në drejtësi për të gjithë pa dallime. Me të vërtetë, sa më e lartë të jetë vetëdija shoqërore për këto, aq më shumë kërkesa për dhe realizimi i qasjes në drejtësi.

---

<sup>6</sup> ADRC – MCM.




Manuali është bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi (shih në fund) dhe është përpiluar nga ekspert të fushës të asistuar nga përfaqësues/e të projektit në një formë sa më të kuptueshme, të përmbledhur dhe të thjeshtë. Si i tillë, synon të pajisë lexuesin e zakonshëm dhe publikun e gjerë me informacione dhe njohuri relevante dhe praktike dhe aspiron që të shërbejë si një ndër pikat e para, të shpejta dhe praktike të referimit kur bëhet fjalë për kuptimin e sistemit të drejtësisë në vend dhe qasjen në drejtësi.

## 1. TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE DHE SISTEMI I DREJTËSISË

---

Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës realizohet përmes institucioneve të saj legislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kosova është republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit dhe balancimit në mes tyre. Lidhur me ndarjen e pushteteve, Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe të politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Sa i përket pushtetit gjyqësor ai është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

Akti më i lartë juridik, **Kushtetuta** e vendit i garanton secilit/ës, pa as një lloj diskriminimi, **të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore**. Secilit/ës i garantohet **e drejta e lirisë dhe sigurisë** dhe askush nuk mund të privohet nga liria përveç në rastet e përcaktuara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente. Kushtetuta përcakton **të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm** përmes së cilës, të gjithë kanë të drejtë në mbrojtje të barabartë në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Kështu, sipas Kushtetutës, çdokush gëzon të drejtën për **shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm** lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet që ka ose për cilëndo akuzë penale që ngritet kundër tij/saj brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. Në kuadër të të drejtave, po ashtu secili/a ka **të drejtë të përdorë mjetet juridike** kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij/saj në mënyrën e përcaktuar me ligj. Kur ju referohemi të drejtave, në kuadër të Kushtetutës është e siguruar edhe **e drejta e pronës**, ku shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik si dhe askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Këto dhe të drejta dhe liri të tjera themelore të parashikuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat, për shkak të hapësirës së kufizuar nuk mund të elaborohen më shumë dhe gjëresisht, vlejnë edhe për personat juridike, për aq sa janë të zbatueshme.





Për fund, është me rëndësi të theksohet se **Kapitulli III** i Kushtetutës (Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre) parasheh dhe garanton edhe një sërë të drejta të veçanta, krahas të drejtave dhe lirive themelore disa prej të cilave janë të përmendura më lartë, për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre.

Kosova në raport me vlerat universale të të drejtave dhe lirive të njeriut ka inkorporuar në Kushtetutën e saj një sërë instrumente ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe që zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejte në vend. Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të aplikueshme në Kosovë janë:

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj;

Konventa Kornizë e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese;

Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

## 2. GJYKATA THEMELORE DHE QASJA NË DREJTËSI

### 2.1. Gjykata Themelore

Shpesh ndodh që nga raportet ndër-njerëzore të lindin konteste apo mosmarrëveshje të cilat mund të kenë të bëjnë me aspekte apo çështje pasurore, pronësore, familjare, trashëgimore, tregtare, kontraktuese, etj. Tek këto konteste apo mosmarrëveshje, çdo herë palët pretendojnë se janë ata/o që kanë të drejtë dhe u janë cenuar, mohuar apo shkelur të drejtat e tyre subjektive. Në këtë rast, është sistemi gjyqësor që mundëson trajtimin e çdo kontesti dhe mosmarrëveshje dhe që përcakton se cila palë ka të drejtë në atë që pretendon dhe dëshiron dhe për këtë sjell vendime që kanë karakter detyrues për palët. Për të bërë këtë dhe mbrojtjen e të drejtave në vend, ekziston sistemi i gjyqësor që është fillimisht i paraparë me Kushtetutë dhe ka një organizim, funksionim dhe juridiksion të rregulluar sipas legjislacionit përkatës në fuqi.



**Sistemi gjyqësor** në Republikën e Kosovës përbëhet nga Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.<sup>7</sup>

**Gjykatat Themelore** janë gjykata të shkallës së parë dhe kështu gjykojnë në shkallë të parë. Në territorin e Kosovës ekzistojnë shtatë (7) Gjykata Themelore me degët e tyre si në vijim:


- ⇒ **Gjykata Themelore e Prishtinës** e cila vepron për territorin e Komunës së Prishtinës dhe ka degët e saj në Lipjan, Podujevë, Glogovac dhe Graçanicë;
- ⇒ **Gjykata Themelore e Mitrovicës** e cila vepron për territorin e Komunave të Mitrovicës së jugut dhe Mitrovicës së veriut dhe ka degët e saj në Leposaviq, Zubin Potok, Skenderaj dhe Vushtrri;
- ⇒ **Gjykata Themelore e Ferizaj** e cila vepron për territorin e Komunës së Ferizaj dhe ka degët e saj në Kaçanik dhe Shtërpçë;
- ⇒ **Gjykata Themelore e Gjakovës** e cila vepron për territorin e Komunës së Gjakovës dhe ka degët e saj në Malishevë dhe Rahovec;
- ⇒ **Gjykata Themelore e Gjilanit** e cila vepron për territorin e Komunës së Gjilanit dhe ka degët e saj në Kamenicë, Novobërdë dhe Viti;
- ⇒ **Gjykata Themelore e Pejës** e cila vepron për territorin e Komunës së Pejës dhe ka degën e saj në Deçan që mbulon edhe Junikun, Istogun dhe Klinën;
- ⇒ **Gjykata Themelore e Prizrenit** e cila vepron për territorin e Komunës së Prizrenit dhe ka degët e saj në Dragash dhe Suharekë.

Kompetencat dhe organizimi i brendshëm i Gjykatës Themelore është i ndarë në departamente që veprojnë brenda saj, me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas kompetencës dhe natyrës së tyre dhe atë si në vijim:

- ⇒ **Departamenti për Krimet e Rënda**, që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, gjykon veprat penale të dënueshme mbi dhjetë (10) vite, si dhe veprat penale që konsiderohen krime të rënda sipas Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale. Ky departament aktivizohet që në momentin kur nga Prokuroria Themelore i dërgohen *aktakuza* që janë ngritur nga kjo e fundit.
- ⇒ **Departamenti i Përgjithshëm**, që vepron në selinë dhe degën e secilës Gjykatë Themelore, gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, nga kontestet e marrëdhënieve juridike-civile dhe veprat penale. Ky departament sa i përket çështjeve civile aktivizohet kur palët parashtrajnë *padi*. Ndërsa për veprat penale, atëherë kur Prokuroria Themelore i dërgon *aktakuza* që janë ngritur nga kjo e fundit.

---

<sup>7</sup> Ky manual do të trajtoj vetëm gjykatat e rregullta, por jo edhe Gjykatën Kushtetuese e cila nuk është pjesë e sistemit të rregullt gjyqësor përkatësisht gjykatë e rregullt dhe për faktin se kjo gjykatë ka në fushëveprimtari vlerësimin e kushtetutshmërisë.



⇒ **Departamenti për të Mitur**, që vepron në kuadër të secilës Gjykatë Themelore dhe aktivizohet atëherë kur nga Prokuroria Themelore i dërgohen *aktakuza* të cilat i ka ngritur kjo e fundit.

Në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, vepron po ashtu **Departamenti Special** për Lëndët të cilat hetohen dhe ngritën *aktakuza* nga Prokuroria Speciale me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ky departament aktivizohet në momentin kur nga Prokuroria Speciale i dërgohen *aktakuzat* që i ngrit kjo prokurori dhe kërkon që të trajtohen dhe vendosen në këtë departament. Edhe Departamenti për **Çështjet Administrative** vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë me juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Ky departament gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas *padive* kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet tjera të përcaktuara me ligj.

Në kuadër të sistemit gjyqësor është edhe **Gjykata Komerciale**, organizimi dhe funksionimi i së cilës është i rregulluar me ligjin përkatës. Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive që ka, kjo gjykatë është përgjegjëse që të trajtoj dhe zgjidh të gjitha **kontestet tregtare** dhe **konfliktet administrative**. Ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe selia e saj është në Prishtinë.

Sipas **lëndës**, Gjykata Themelore është kompetente për të trajtuar dhe gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet. Kjo gjykatë është po ashtu kompetente edhe për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja. Përpos këtyre, ajo bën mbajtjen e evidencës së personave të dënuar dhe lëshimin e certifikatës mbi të kaluarën kriminale dhe mbi bazën e kërkesës qytetari mund ta nxjerr këtë në çdo moment dhe atë online.

Me qëllim të informimit për fushëveprimtarinë e sistemit gjyqësor dhe komunikimit me Gjykatat Themelore, qytetarët në çdo kohë mund të qasen në faqen zyrtare të KGJK-së,<sup>8</sup> [www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org)




## 2.2. Qasja në Gjykatën Themelore

Sistemi gjyqësor në Kosovë është i thirrur që të trajtojë të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë, ku asnjë qytetar nuk mund të diskriminohet. Secili/a qytetar/e i/e Kosovës mund t'i qaset Gjykatës Themelore për të paraqitur pretendimet e tij/saj se ndonjë e drejtë e tij/saj është cenuar apo shkelur dhe për të pranuar shërbime të ndryshme të referuara si më lartë. Secili/a person fizik apo juridik ka

---

<sup>8</sup> KGJK është institucion i pavarur që bën administrimin e gjykatave në Kosovë dhe që duhet të sigurojë pavarësinë, mosdiskriminimin, proporcionalitetin, profesionalizmin dhe paanshmërinë e tyre. Ndër të tjera, ka për detyrë që të sigurojë që gjykatat pasqyrojnë natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës dhe të ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë.



të drejtë të marrë shërbime gjyqësore dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm për çështjen që ka në gjykatë. Gjykatës Themelore mund t'i qaset çdo qytetar qoftë në formë fizike apo përmes postës duke cekur adresën e saktë të dërguesit që gjykata të ketë të njohur se ku të drejtojë përgjigjen.

Në Gjykatën Themelore, mund të kërkohet mbrojtja apo realizimi i një të drejte ligjore që i referohet marrëdhënieve juridike-civile dhe atë si në vijim:

- ⇒ **të drejtave pronësore** si: mbrojtja e pronësisë, të drejtave sendore, e drejta fqinjësore, mbrojtja e posedimit, pengut, hipoteka dhe çdo kontest apo mosmarrëveshje që ju referohet marrëdhënieve juridiko-pronësore;
- ⇒ **marrëdhënieve detyrimore**, përkatësisht kontesteve apo mosmarrëveshjeve që ju referohen: kontratave, shkaktimit të dëmit, pasurimit pa bazë, gjerimit të punëve të huaja pa porosi, shprehja e njëanshme e vullnetit, përkatësisht premtimi publik i shpërblimit;
- ⇒ **marrëdhënieve familjare** përkatësisht kontesteve apo mosmarrëveshjeve që ju referohen: fejesës, martesës, shuarjës së martesës, marrëdhënieve ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimit (birësimit), kujdestarisë, mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhënieve pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet apo mosmarrëveshjet lidhur me marrëdhëniet familjare;
- ⇒ **marrëdhëniet trashëgimore** përkatësisht kontestet apo mosmarrëveshjet që ju referohen: trashëgimisë me ligj, transaksionet ndërmjet të gjallëve (*inter vivos*), trashëgimisë me testament, kreditorëve të pasurisë. Kur masa trashëgimore në çfarëdo formë është kontestuese mes trashëgimtareve, ky kontest apo mosmarrëveshje trajtohet nga Gjykata Themelore e cila pritet të sjell *aktgjykim* meritor;
- ⇒ **marrëdhënieve të punës** e që përfshijnë: pagën, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, mos-vazhdimin e kontratës, etj. Kontestet apo mosmarrëveshjet nga marrëdhënia e punës, kryesisht trajtohen me më prioritet dhe më shpejt se lëndët tjera.

Për të gjitha këto konteste apo mosmarrëveshje nga fushat e cekura më lartë, akti juridik i shkruar me të cilin mund t'i qasemi Gjykatës Themelore është *padia* e cila duhet të dorëzohet në gjykatën në fjalë, Departamentit të Përgjithshëm qoftë fizikisht apo përmes postës. *Padia*, akti juridik me të cilin iniciohet një çështje në Gjykatën Themelore dhe përmes së cilës mund të kërkohet mbrojtje gjyqësore, duhet të përmbajë kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore, faktet mbi të cilat paditësi/ja e bazon kërkesën, provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla, vlerën e kontestit, dhe bazën juridike. Nga Gjykata Themelore nuk ka kufizim se nga kush duhet të përgatitet *padia*, ajo mund të shkruhet nga vetë pala që ka kërkesë/kontest apo mosmarrëveshje me palën tjetër, apo të shkruhet nga avokati/ja që është profesionist/e i/e kësaj lëmie.



## 2.3. Skema praktike e qasjes në Gjykatën Themelore në marrëdhëniet juridiko-civile

Kontesti apo mosmarrëveshja nga fusha:

- ⇒ Pronësore
- ⇒ Kontraktuale
- ⇒ Familjare
- ⇒ Trashëgimore

Konsultimi me avokatin/en për:

1. Kontestin dhe mundësinë e procedimit për në Gjykatën Themelore
2. Hartimin e *padisë*
3. Përfaqësimin në gjykatë

Hartimi i *padisë* nga:

- ⇒ Avokati/ja
- ⇒ Pala

Dorëzimi i *padisë* në Gjykatën Themelore, përmes formës:

- ⇒ Fizikisht duke e dorëzuar në Gjykatën Themelore
- ⇒ Duke e dorëzuar në postë

Procedura gjyqësore në Gjykatën Themelore, përbëhet prej dy seancave gjyqësore:

1. Seancës përgatitore<sup>9</sup>
2. Seancës për shqyrtim kryesor të çështjes<sup>10</sup>


*Aktgjykimi* i Gjykatës Themelore

Zgjidhja e kontestit apo mosmarrëveshjes dhe realizimi/mbrojtja e të drejtave nga fusha:

- ⇒ Pronësore

<sup>9</sup> Seanca përgatitore mundëson që gjyqtari/ja në mënyrë metodike të vlerësojë nëse palët janë të gatshme të paraqesin dëshmitë relevante dhe të pranueshme në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes. Po ashtu, seanca përgatitore është projektuar si një mundësi për gjyqtarin/en që të përcaktojë nëse është e mundur të arrihet një zgjidhje alternative e kontestit, qoftë nëpërmjet të ujdisë gjyqësore apo nëpërmjet procedurës së ndërmjetësimit, duke shmangur kështu gjykimin e çështjes.

<sup>10</sup> Në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes bëhet përshkrimi i objektit të shqyrtimit kryesor dhe adresohen çështjet të cilat konsiderohen relevante për vendosjen e çështjes kontestuese. Po ashtu në këtë seancë prezantohen edhe provat të cilat do të nxirren në seancën e shqyrtimit kryesor dhe personat të cilët duhet të thirren në seancën e shqyrtimit kryesor.



- ⇒ Kontraktuale
- ⇒ Familjare
- ⇒ Trashëgimore

## 3. GJYKATA E APELIT DHE QASJA NË DREJTËSI

---

### 3.1. Gjykata e Apelit

**Gjykata e Apelit** vepron si gjykatë e shkallës së dytë në kuadër të sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Ka juridiksion për të gjithë territorin dhe selinë në Prishtinë.


Në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi, Gjykata e Apelit ka në kompetencë të shqyrtojë të gjitha *ankesat* e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjykata e Apelit ka një organizim të brendshëm të ndarë në departamentet si në vijim:

- ⇒ Departamenti i Përgjithshëm;
- ⇒ Departamenti për Krime të Rënda;
- ⇒ Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës;
- ⇒ Departamenti për Çështje Administrative;
- ⇒ Departamenti për të Mitur.

### 3.2. Qasja në Gjykatën e Apelit

Secili/a qytetar/e ka qasje të barabartë në gjykatë në kuadër të sistemit gjyqësor në Kosovë. Kështu çdo person ka drejtë t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij/saj të ligjshme dhe të përdor mjete juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtën apo interesat e tij/saj në mënyrën e caktuar me ligj. **E drejta në *ankesë*** kundër vendimeve gjyqësore fillimisht është kategori, përkatësisht e drejtë kushtetuese dhe më pas është e rregulluar edhe në mënyrë specifike me legjislacionin përkatës. Rregullimi përkatës i *ankesës* është i realizuar në çdo fushë të së drejtës, ku edhe në kontestet apo mosmarrëveshjet nga marrëdhëniet juridiko-civile, kjo është e përcaktuar në legjislacionin përkatës për procedurën kontestimore.

Kundër *aktgjykimit* të dhënë nga Gjykata Themelore përkatësisht ajo e shkallës së parë, palët mund të parashtrojnë *ankesë* brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së *aktgjykimit* palës në Gjykatën e Apelit. Në momentin që pala parashtron *ankesë*, *ankesa* e parashtruar



në Gjykatën e Apelit pengon që *aktgjykimi* i Gjykatës Themelore të bëhet i formës së prerë në pjesën e goditur me *ankesë* dhe kështu nuk mund të prodhojë efekte juridik për palët. Pra, për *ankesën* e parashtruar ndaj *aktgjykimit* të Gjykatës Themelore përkatësisht asaj të shkallës së parë, vendos Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë. Që ankesa të jetë e kompletuar duhet të përmbaj këto elemente:

- ⇒ tregimin e aktgjykimit kundër të cilit paraqitet *ankimi*, pra kundër cilit *aktgjykim* saktësisht;
- ⇒ deklaratën se *aktgjykimi* kundërshtohet në tërësi ose vetëm në pjesën e caktuar;
- ⇒ shkaqet e *ankimit* bashkë me arsyetimin për këtë;
- ⇒ nënshkrimin e paraqitësit të *ankimit*.

Legjislacioni përkatës në fuqi, ka përcaktuar qartë dhe në mënyrë precize saktë se *aktgjykimi* i Gjykatës Themelore përkatësisht i asaj të shkallës së parë, mund të goditet:

1. për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, pra nëse pala ka identifikuar se Gjykata Themelore gjatë rrjedhës së procedurës gjyqësore, ka shkelur dispozitat përkatëse kontestimore;
2. për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, pra kur Gjykata Themelore nuk ka qenë e saktë në konstatim të gjendjes faktike dhe kjo ka rezultuar në vendimmarrje përkatësisht *aktgjykim* të gabuar dhe rrjedhimisht palës u janë shkelur të drejtat;
3. për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, kjo është shkelja e cila reflekton direkt në shkeljen dhe mohimin e të drejtave të palëve.

Gjykata e Apelit në kapacitetin e gjykatës së shkallës së dytë, brenda kompetencave ligjore mundet:

- ⇒ të hedhë poshtë *ankesën* si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;
- ⇒ të prishë *aktgjykimin* e goditur dhe të hedhë poshtë *padinë*;
- ⇒ të prishë *aktgjykimin* e goditur dhe të kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;
- ⇒ të refuzoj *ankesën* si të pabazë dhe të vërtetojë *aktgjykimin* e goditur;
- ⇒ të ndryshoj *aktgjykimin* e shkallës së parë.

Duke qene gjykatë e shkallës së dytë, Gjykata e Apelit ka në kompetencë që të ndërmerr veprime përkatëse e të cilat janë në funksion të eliminimit të çdo shkelje eventuale të bërë nga Gjykata Themelore. Andaj veprimet e Gjykatës së Apelit, janë në funksion të qasjes në *ankesë* dhe drejtësi si mekanizma që mundësojnë mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave, e të cilat janë parakusht i shtetit të së drejtës.



## 4. GJKATA SUPREME DHE QASJA NË DREJTËSI

---

### 4.1. Gjykata Supreme

**Gjykata Supreme** është autoriteti më i lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës. Pra në aspektin e hierarkisë në kuadër të sistemit gjyqësor, Gjykata Supreme është mekanizmi më i lartë. Ka juridiksionin përkatësisht kompetencë për të gjithë territorin dhe selinë në Prishtinë. Gjykata Supreme ka të përcaktuar edhe kompetencën dhe fushëveprimin dhe vendosë lidhur me:


- ⇒ kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës;
- ⇒ revizionin kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit, përkatësisht asaj të shkallës së dytë në çështjet kontestimore;
- ⇒ vendos në shkallë të tretë për ankesat kur ato janë të lejuara me ligj;
- ⇒ përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës;
- ⇒ vendos lidhur me lëndët e Agjencisë Kosovare të Pronës, siç parashihet me ligj;
- ⇒ në Dhomën e Posaçme, lëndët e Agjencionit Kosovar të Privatizimit ose të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, siç parashihet me ligj.

Duke qenë në hierarki instanca më e lartë në sistemin gjyqësor, Gjykata Supreme në kuadër të kompetencave të saj, në formë specifike ka kompetencë mjetet e jashtëzakonshme juridike për trajtimin e të cilave duhet që të jenë të plotësuar disa kushte ligjore. Është mekanizëm që mundëson të eliminohet çdo shkelje eventuale në kuadër të sistemit gjyqësor qoftë në nivelin e shkallës së parë (atë themelor) apo të shkallës së dytë (atë të apelit). Në kuadër të Gjykatës Supreme funksionojnë degët si në vijim:

- ⇒ Dega penale;
- ⇒ Dega civile;
- ⇒ Dega administrative;
- ⇒ Praktika gjyqësore.

### 4.2. Qasja në Gjykatën Supreme

Gjykatës Supreme mund t'i qaset çdo qytetar pa dallim, dhe të kërkojë mbrojtje juridike për të gjitha ato konteste për të cilat gjykatat kompetente të shkallëve më të ulëta kanë marrë vendim, e për të cilat sipas legjislacionit përkatës në fuqi mund të kërkohet mbrojtje juridike nga Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e shkallës së tretë. Gjykatës Supreme, mund t'i qasemi përmes mekanizmave





përkatësisht mjeteve të jashtëzakonshme juridike si në vijim, të cilat janë të aplikueshme për të kontestet nga të gjitha fushat e së drejtës:

- ⇒ Revizioni;
- ⇒ Përsëritja e procedurës;
- ⇒ Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

## 5. SISTEMI PROKURORIAL DHE QASJA NË DREJTËSI

---


### 5.1. Prokuroria Themelore


**Prokurori i Shtetit** është mekanizëm, përkatësisht, institucion i pavarur që ka autoritet dhe përgjegjësi ndjekjen penale për vepër penale, e që konsiderohet vepër e kundërligjshme dhe që sanksionohet me legjislacionin përkatës në fuqi përkatësisht me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të kornizës përkatëse ligjore. Ky institucion duhet të reflektojë përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe të respektojë parimet e barazisë gjinore. Prokurori i Shtetit është e organizuar në aspektin funksional si në vijim:

- ⇒ **Prokuroria Themelore** e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda;
- ⇒ **Prokuroria e Apelit** e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda;
- ⇒ **Prokuroria Speciale**;
- ⇒ **Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.**

Prokuroria Themelore ka juridiksion, përkatësisht, kompetencë mbi të gjitha lëndët e shkallës së parë. Në aspektin e kompetencës territoriale, ka këtë mbulim:

- ⇒ **Prokuroria Themelore në Prishtinë**, për gjithë territorin e Gjykatës Themelore të Prishtinës;
- ⇒ **Prokuroria Themelore në Mitrovicë**, për gjithë territorin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës;
- ⇒ **Prokuroria Themelore në Ferizaj**, për gjithë territorin e Gjykatës Themelore të Ferizaj;
- ⇒ **Prokuroria Themelore në Gjakovë**, për gjithë territorin e Gjykatës Themelore të Gjakovës;
- ⇒ **Prokuroria Themelore në Gjilan**, për gjithë territorin e Gjykatës Themelore të Gjilanit;
- ⇒ **Prokuroria Themelore në Pejë**, për gjithë territorin e Gjykatës Themelore të Pejës;
- ⇒ **Prokuroria Themelore në Prizren**, për gjithë territorin e Gjykatës Themelore të Prizrenit.



Më shumë informata për punën dhe shërbimet e sistemit prokurorial dhe komunikimit me Prokuroritë Themelore, mund të gjenden në faqen zyrtare të KPK-së,<sup>11</sup> [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org) 

## 5.2. Qasja në Prokurorinë Themelore

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore që janë përcaktuar me legjislacionin përkatës në fuqi, janë paraparë një sërë sanksione për ata/o që i cenojnë, dëmtojnë, përvetësojnë apo mohojnë këto të drejta dhe liri të cilat janë të mbrojtura me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Kur këto cenohen, dëmtohen, përvetësohen apo mohohen duhet t'i bëhen të ditura Policisë dhe Prokurorisë Themelore si mekanizma që janë kompetent për luftimin e kriminalitetit.


Akti juridik me të cilin i bëhet e njohur Prokurorisë Themelore se një e drejtë e mbrojtur dhe sanksionuar me Kodin Penal është shkelur, është **kallëzimi penal**. Përmes **kallëzimit penal**, çdo person ka të drejtë të kallëzojë veprën penale që ndiqet më pas nga ana e Prokurorisë Themelore dhe në raste të caktuara ekziston dhe detyrimi që të kallëzojë. Në funksion të mbrojtjes së rendit dhe të drejtave të mbrojtura me Kodin Penal është edhe **Policia e Republikës së Kosovës**. Ky mekanizëm është në shërbim të sistemit prokurorial sa i përket luftës kundër krimit dhe dukurive negative. Kështu, qytetari kur dyshon për një vepër penale përmes së cilës është cenuar një e drejtë apo e mirë që është e mbrojtur dhe sanksionuar me Kodin Penal, mund ta paraqet dhe lajmëron në polici. Në këto raste, duke u bazuar në të dhënat dhe provat e mblidhura, policia përpilon **kallëzim penal** që i dorëzohet më pas prokurorisë së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet e tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës penale.

Për qëllim të lajmërimit të një vepre penale e cila ka cenuar të drejtat dhe mirat që janë të mbrojtura dhe sanksionuara me Kodin Penal, qytetari i vendit ka mundësi që vetë apo përmes avokatit/es të përpilon dhe dorëzojë **kallëzimin penal**.

Kur policia, qytetari apo ndonjë agjension tjetër qeveritar bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një vepër penale, prokurori i shtetit mund të fillojë fazën e hetimit të procedurës penale. Prokurori i shtetit mund të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera, nëse ka dyshim të arsyeshëm se po ndodh ose ka gjasë të ndodh në një të ardhme të afërt vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Qëllimi i hetimit është që të mblidhen provat dhe të dhënat e nevojshme për të vendosur nëse ka dyshim për vepër penale dhe duhet të ngritet **aktakuza** apo të pushohet procedura.


---

<sup>11</sup> KPK është institucion i pavarur që bën administrimin për një sistem prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm si dhe siguron që, ndër të tjera, prokuroritë të pasqyrojnë natyrën shumetenike të Republikës së Kosovës.



Hetimi fillohet me *aktvendim* të prokurorit të shtetit. *Aktvendimi* përcakton personin kundër të cilit/ës do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, nëse masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar dhe provat me të dhënat e mbledhura deri në atë moment.

### 5.3. Skema praktike e qasjes në Prokurorinë Themelore



## 5.4. Prokuroria e Apelit

**Prokuroria e Apelit** është mekanizëm në kuadër të sistemit prokurorial që ka në kompetencë dhe fushëveprim parashtrimin e *ankesave* kundër *aktgjykimeve* të Gjykatës Themelore dhe degëve të saj, kur këto nxjerrin *aktgjykime* që sipas prokurorisë nuk janë konform legjislacionit përkatës në fuqi dhe të njëjtat përmbajnë shkelje dhe të meta ligjore. Prokuroria e Apelit ofron mbrojtje juridike në Gjykatën e Apelit. Nga kompetenca që ka, Prokuroria e Apelit është instanca e dytë në sistemin prokurorial. Ajo ka juridiksion përkatësisht kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe selinë në Prishtinë.


## 5.5. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit** udhëhiqet nga Kryeprokurori/ja i/e Shtetit dhe ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka në kompetencë që të trajtojë dhe procedojë lëndët në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme, si dhe të gjitha lëndët që përfshijnë mjete të jashtëzakonshme juridike, pra ka funksionin e mbikëqyrjes në nivelin më të lartë të hierarkisë. Kjo Zyrë mund të marrë në kompetencë secilën lëndë në secilën prokurori të vendit siç është përcaktuar me ligj.


Kryeprokurori/ja i/e Shtetit është kreu i Prokurorisë së Shtetit dhe ka përgjegjësi të gjithmbarshme për menaxhimin e Prokurorisë së Shtetit dhe mbikëqyrjen e të gjithë prokurorëve. Kryeprokurori/ja i/e Shtetit nxjerr rregulla, instruksione, udhëzime dhe vendime për rregullimin e brendshëm të Prokurorisë së Shtetit.

## 5.6. Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave

Në kuadër të sistemit të prokurorisë funksionon edhe **ZMNV** që ndihmon viktimat e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, abuzimit, fëmijët e keqtrajtuar, dhunimit, vrasjes si dhe viktimat tjera të krimit dhe përfaqëson këta/o në polici, prokurori dhe gjykatë. Ajo është e pavarur dhe vepron përmes zyrës së saj qendrore në Prishtinë por i ka dhe shtatë (7) zyra rajonale të vendosura pranë Prokurorive Themelore. Zyrtarët e saj punojnë në raste të veçanta njëzetë e katër (24) orë në ditë dhe shtatë (7) ditë në javë në gjithë vendin. Ata/o janë të thirrur që të ofrojnë mbështetje dhe ndihmë viktimave të krimit për të pasur qasje në organet e drejtësisë, për të njoftuar palën e dëmtuar për të drejtat e tij/saj, dhe për përfaqësimin e interesave të viktimës në procedurë në prokurori dhe gjykatë. Kur është e nevojshme, zyrtarët e kësaj zyre po ashtu i referojnë viktimat e krimit tek ofruesit tjerë të shërbimeve, veprojnë në emër të tyre kur është e nevojshme dhe e duhur për të ndaluar shkeljen e të drejtave dhe për të kërkuar veprim për garantimin e mbrojtjes së tyre.



ZMNV ka në funksion numrin telefonik publik dhe pa pagesë; është mekanizëm konfidencial për raportimin e veprave të ndryshme penale të abuzimit dhe referon, këshillon, informon ata/o në nevojë për të drejtat e tyre dhe përpaket që t'i lidhë ata/o me shërbimet përkatëse. Linja telefonike në fjalë vepron shpejtë për të ofruar shërbime gjatë gjithë kohës. Numri publik kontaktues është si në vijim: **0800 11112** 📞 Ky numër është krejtësisht falas dhe i hapur non-stop. Thirrjet dhe ajo se çfarë raportohet në linjën ndihmëse është konfidenciale.

Më shumë qasje në lidhje me ZMNV si dhe sistemin prokurorial në përgjithësi edhe njëherë mund të gjendet në [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org) 

## 6. MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR DREJTËSINË

---

Në kuadër të dialogut të Brukselit në vitin 2013, Kosova dhe Serbia nënshkruan një Marrëveshje për Normalizimin e Marrëdhënieve, e njohur si "Marrëveshja e Brukselit".<sup>12</sup> Kjo marrëveshje, ndër të tjera, parashikoi integrimin e autoriteteve gjyqësore në rajonin e Mitrovicës, funksionimin e tyre brenda kornizës së Kosovës dhe aplikimin e ligjeve të Kosovës në/nga këto. Kjo pikë lidhur me sistemin e drejtësisë, u pasua me një marrëveshje të mëvonshme, të nënshkruar në mes palëve në vitin 2015 për implementimin e integritit të drejtësisë, e cila në mënyrë specifike përcaktoi bazën për një Gjykatë të **vetme** Themelore për rajonin e Mitrovicës për t'u udhëhequr nga një gjykatës/e të përkatësisë serbe të Kosovës.<sup>13</sup> Gjykata do të kishte (ka) kompetencë për gjithë rajonin e Mitrovicës dhe do vendosej në dy (2) lokacione, në komunën e Mitrovicës së jugut dhe atë të Mitrovicës së veriut.<sup>14</sup> Po ashtu do të kishte edhe katër (4) degët ekzistuese, një (1) në Vushtrri, një (1) në Skenderaj, një (1) në Zubin Potok dhe një (1) në Leposaviq.<sup>15</sup> Sa i përket prokurorisë, Marrëveshja e Brukselit për Drejtësinë përmbante edhe dispozita për **një** Zyrë të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, me kompetencë territoriale për rajonin e Mitrovicës.<sup>16</sup> Kjo prokurori, sipas marrëveshjes, fillimisht do të vendosej në zonën multietnike (Lagjia e Boshnjakëve) dhe drejtohej nga një prokuror/e shqiptar/e të Kosovës.<sup>17</sup>

Edhe pse ishte e paraparë që integrimi dhe implementimi i një sistemi unitar të drejtësisë të ishte funksional deri në shtator 2015, marrëveshja në fjalë filloi implementimin vetëm në fund të vitit 2017, kur në rajonin e Mitrovicës filluan funksionimin dhe punën institucionet e integruara të drejtësisë si

---

<sup>12</sup> Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve ("ADRC"), *Drejtësia në Rajonin e Mitrovicës: Hululumtim i Perceptimit Publik* (mars 2020) f 2.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Po aty.



më lartë.<sup>18</sup> Sipas Marrëveshjes së Brukselit për Integrimin e Drejtësisë, tani po ashtu kemi edhe Divizionin e Apelit në Mitrovicën e veriut.

## 7. SISTEMI I AVOKATISË DHE QASJA NË AVOKAT

**Avokatia** është kategori kushtetuese ku përcaktohet se është profesion i pavarur. Është i rregulluar në mënyrë specifike me ligj që definojnë se është profesion i lirë dhe i pavarur që merret me dhënien e shërbimeve dhe ndihmës juridike personave fizik dhe juridik për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tyre në pajtim me rendin juridik. Avokatia ofron shërbime dhe ndihmë juridike në të cilat hyjnë:

- ⇒ përfaqësimi dhe mbrojtja e personave fizik dhe juridik, shoqëritë afariste dhe subjekteve tjera juridike para gjykatave dhe organeve tjera shtetërore;
- ⇒ përfaqësimi i personave fizik dhe juridik në punët e tyre juridike, në zgjidhjen miqësore të kontesteve apo mosmarrëveshjeve dhe raporteve kontestuese;
- ⇒ dhënia e këshillave dhe mendimeve juridike;
- ⇒ hartimi i padive, kërkesave, propozimeve, lutjeve, mjeteve juridike dhe parashtresave tjera;
- ⇒ hartimi i kontratave, marrëveshjeve, testamenteve, deklaratave, akteve të përgjithshme dhe të veçanta si dhe dokumenteve tjera;
- ⇒ kryerja e punëve tjera juridike në emër dhe për llogari të personave fizik dhe juridik, vendor apo të huaj, në bazë të të cilave realizohen dhe mbrohen të drejta dhe interesa.


Për shembull, në një rast penal që zhvillohet në gjykatë, ku kemi Prokurorinë e Shtetit, gjyqtarin/en dhe avokatin/en, avokati/ja është i/e angazhuar dhe ka rol që palën e akuzuar ta mbroj, këshilloj dhe njoftoj në detaje për të gjitha ato që i referohen rastit në fjalë. Pra, avokati/ja është përfaqësues/e i/e palës, që çdo gjë që realizon është në funksion të mbrojtjes së palës që akuzohet.

Avokati/ja me rastin e ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës juridike ka të drejtë për pagesë të honorarit dhe kompensim të shpenzimeve për punën e tij/saj. Ai/ajo ka po ashtu për obligim që brenda një (1) viti kalendarik të ofrojë një numër të shërbimeve dhe/apo ndihmës juridike pa pagesë për ata/o me çështje juridike në gjendje të vështirë socio-ekonomike, si dhe për rastet tjera të parapara me aktet nënligjore të OAK-së. **OAK** është organizatë vetëqeverisëse dhe e pavarur e avokatëve të vendit që vepron si trup ombrellë për këta të fundit; ka disa qëllime kryesore ndër të tjera, avancimin e sundimit

<sup>18</sup> Po aty, f 2 – 3.



të ligjit në Kosovë dhe përmirësimin e drejtësisë dhe përmirësimin e përgatitjeve profesionale të anëtarëve të saj.<sup>19</sup> Ajo është autoriteti i vetëm për licencimin e avokatëve në vend.<sup>20</sup>

Me qëllim të informimit për fushëveprimtarinë e Avokatisë dhe çdo gjëje që ndërlidhet me avokat/e, qytetarët mund të qasen në faqen zyrtare të OAK-së, në [www.oak-ks.org](http://www.oak-ks.org)  Kjo qasje mundëson që qytetarët të informohen dhe të sigurojnë kontaktet e avokatëve për tërë territorin e vendit.

## 8. INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT DHE QASJA NË DREJTËSI

---

IAP mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike dhe është i pavarur në ushtrimin e detyrës. Ka kompetenca për të hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik dhe juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore si të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet dhe aktet tjera, si dhe me instrumentet ndërkombëtare të lirive dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit. IAP ka kompetencë të zhvillojë hetime qoftë në përgjigje të *ankesës* së parashtruar pranë tij apo me vetë iniciativën e vet, nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve publike janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me rendin dhe kornizën juridike të Republikës së Kosovës.

IAP ka disa nga këto përgjegjësi:

- ⇒ të hetojë dhe angazhohet për eliminimin e shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut dhe diskriminimin;
- ⇒ të tërheqë vëmendjen në rastet kur autoritetet publike shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandime përkatëse;
- ⇒ të hartojë dhe miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët, si dhe krijimin e një ekipi të specializuar dhe programi vetëdijësues për të drejtat e fëmijëve;
- ⇒ të punojë për ngritjen e vetëdijesimit për të drejtat e njeriut dhe të avancojë ato përmes rekomandimeve të ndryshme;

---

<sup>19</sup> OAK, "RRETH NESH" (OAK, 2022) <<https://www.oak-ks.org/rreth-nesh>> qasur më 05 nëntor 2022.


<sup>20</sup> Po aty.



⇒ të përgatisë dhe publikojë opinione, propozime, iniciativa dhe raporte në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Çdo person që pretendon se të drejtat dhe liritë e tij/saj janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të autoriteteve publike, mund të kërkojë nga IAP fillimin e procedurës nga IAP. Çdo ankesë që i parashtrohet IAP-së duhet të jetë e nënshkruar dhe të ketë shënimet personale të paraqitësit së ankesës si dhe të përmbajë të gjitha rrethanat, faktet dhe dëshmitë në të cilat kjo ankesë bazohet. Paraqitësi/ja i/e ankesës duhet të deklarojë nëse mjetet juridike (ato mjete ankimore të organit që pretendohet se ka kryer veprimin apo ka nxjerr vendimin për të cilin kërkohet që të aktivizohet IAP) janë ushtruar apo jo, dhe nëse po cilat prej këtyre mjeteve janë zbatuar.

Kërkesa për fillimin e procedurës mund të paraqitet në mënyrë elektronike dhe gojarisht, në rast se nuk mund të bëhet me shkrim. Pas pranimit të ankesës, IAP në afat prej dhjetë ditë (10) pune duhet të vendosë për pranueshmerinë e çështjes dhe nëse do të shqyrtojë çështjen në procedurë të përshpejtuar, do të fillojë hetim të plotë apo hedhë poshtë ankesën. Në të gjitha rastet si më lartë, IAP e njofton me shkrim palën brenda tridhjetë ditësh (30) nga dita e pranimit të ankesës.


Me qëllim të informimit për IAP dhe kontaktit me të, qytetarët në çdo kohë mund t'i qasen faqes zyrtare në [www.oik-rks.org](http://www.oik-rks.org) 

## 9. NDIHMA JURIDIKE FALAS DHE QASJA NË DREJTËSI

---

### 9.1. Agjensioni për Ndhimë Juridike Falas

Qytetarët mund të kenë konteste apo mosmarrëveshje, mirëpo mund të mos kenë njohuri për procedurën dhe formën që duhet ndjekur për të realizuar apo mbrojtur të drejtën dhe interesin e tyre. Me qëllim të inicimit dhe zhvillimit të procedurës gjyqësore, pala ka mundësi që të angazhojë avokat/e që ka kosto financiare për shërbimet e tij/saj që ofron. Kështu, Republika e Kosovës është përkujdesur që për kategorinë e qytetarëve të saj të cilët i kanë kushtet e vështira ekonomike por kanë konteste apo mosmarrëveshje dhe nevojë për shërbime juridike, të ju ofrohet **ndihmë juridike falas**. Në kuadër të sistemit juridik të vendit, këto shërbime i ofron **ANJF** i cili është institucion i pavarur publik që ushtron funksione për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas. ANJF ka zyra rajonale në shtatë (7) rajonet kryesore të vendit duke përfshirë edhe zyra dhe shërbime mobile për të pasur një mbulim sa më të gjërë. ANJF ka në fushëveprimtari të krijojë një sistem funksional për ndihmë juridike





falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

## 9.2. Qasja në Ndhimën Juridike Falas

Si u përmend më parë, me qëllim të lehtësimit të qasjes në drejtësi, ANFJ operon në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe ofron ndihmë juridike falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse. Ndhimja juridike falas ofrohet në formë të:

- ⇒ informatave dhe këshillave juridike lidhur me procedurat ligjore;
- ⇒ përpilimit të shkresave dhe kërkesave tjera teknike që kanë të bëjnë me kompletimin e çështjes apo lëndës respektive;
- ⇒ përfaqësimit në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.


Në mënyrë specifike, shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas ofrohen në kuadër të **ndihmës juridike primare** dhe **sekondare**. Ndhimja juridike primare përfshin shërbimet vijuese:

- ⇒ informata dhe këshilla juridike lidhur me procedurat ligjore;
- ⇒ përpilimin e shkresave dhe ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e çështjes apo lëndës;
- ⇒ përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse;
- ⇒ mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale;
- ⇒ informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat kundërvajtëse;
- ⇒ informatat, këshillat juridike dhe ndihma në procedurat e ndërmjetësimit dhe arbitrazhit ashtu si e paraparë me ligjet në fuqi.

Ndhimja juridike sekondare përfshin shërbimet vijuese:

- ⇒ përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës;
- ⇒ përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.

Në ndihmën juridike falas është kriteri financiar që krijon dallimin në mes të ndihmës juridike primare dhe sekondare. Kështu, ndihma juridike primare u ofrohet të gjithë atyre të cilët përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale, ose janë në situatë të ngjashme me ata/o që përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale. Pra, për të përfituar nga ndihma juridike primare, qytetari duhet të jetë përfitues/e i/e ndihmës sociale ose kushtet e tij/saj socio-ekonomike të janë të ngjashme me ata/o që përfitojnë nga ndihma sociale. Ndërsa, ndihma juridike sekondare u ofrohet atyre kur të ardhurat e tyre të përgjithshme familjare janë më të vogla se sa të ardhurat mesatare familjare në vend. Pra në këtë rast mund të përfitojnë ata/o edhe nëse nuk janë në ndihmë sociale, por që të ardhurat e tyre familjare janë më të vogla se të ardhurat mesatare që ka një familje.



Për të përfituar ndihmë juridike falas, fillimisht kërkohet që të iniciohet kërkesë për këtë në zyrën më të afërt për ndihmë juridike falas. Parashtruesi/ja i/e kërkesës e ka për obligim që të ofrojë dokumentacionin e kërkuar për të provuar bazueshmërinë e kërkesës për ndihmë juridike falas. Në mungesë të dokumentacionit përkatës për kategorinë e viktimave të dhunës, si bazueshmëri e kërkesës merret deklarata me shkrim e mbrojtësit të viktimave. Zyrtarët e zyrës për ndihmë juridike këshillojnë paraqitësin/es duke e mbështetur në mbushjen e formularit e kërkesës. Në rast se kërkuesi/ja i ndihmës juridike paraqet deklarata jo të vërteta, mbi bazën e të cilave bazohet ndihma juridike falas, zyrtarët e ndihmës juridike falas kanë të drejtë që të hulumtojnë gjendjen financiare të përfituesit/es, duke kërkuar pranë çdo organi publik dhënien e informacioneve mbi gjendjen financiare të tij/saj.

Vendimi lidhur me kërkesën për ndihmë juridike falas merret në zyrën për ndihmë juridike falas në të cilën është parashtruar kërkesa. Vendimi për lejimin ose refuzimin e kërkesës merret brenda pesë (5) ditë pune nga dita e dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar. Vendimi për lejimin e ndihmës juridike falas përcakton edhe shërbimet e autorizuar për ndihmë juridike falas të cilat ofrohen në lidhje me kërkesën e aprovuar.

Për më shumë informata në lidhje me ndihmë juridike falas dhe ANJF, vizitoni [www.anjf.rks-gov.net](http://www.anjf.rks-gov.net)



## 10. NDËRMJETËSIMI DHE QASJA NË DREJTËSI

---

### 10.1. Procedura e ndërmjetësimit

**Ndërmjetësimi** është pjesë e sistemit juridik të Republikës së Kosovës dhe është i rregulluar me Ligjin Nr 06/L-009 për Ndërmjetësim. Ndërmjetësimi ka një rëndësi të veçantë për qasjen në drejtësi, është procedurë jashtëgjyqësore që ofron zgjidhjen e kontesteve apo mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës pa as një dallim. Mundëson që një kontest, mosmarrëveshje apo problem në mes dy apo me shumë palëve të zgjidhet pa pasur nevojë që të shkohet në polici, prokurori apo gjykatë. Procedura e ndërmjetësimit është në funksion të qasjes në drejtësi në një kohë të shkurtër (brenda nëntëdhjetë (90) ditësh), me kosto më të ulët të shpenzimeve dhe në mënyrë më të lehtë ku janë palët ato që vendosin për secilën fazë të procedurës duke përfshirë rezultatin e saj, gjë që garanton pronësi mbi procesin. Ajo fillon me nënshkrimin e një marrëveshje që është marrëveshja për hyrje apo fillimin e procedurës së ndërmjetësimit.



Procedura e ndërmjetësimit udhëhiqet apo lehtësohet nga ndërmjetësuesi/ja, i/e cili është palë e tretë, e paanshme dhe licencuar nga MD që është përzgjedhur të ndërmjetësojë në mes palëve me qëllim të zgjidhjes së kontestit apo mosmarrëveshjes dhe arritjes së një marrëveshje në pajtim me parimet e ndërmjetësimit.<sup>21</sup> Ndërmjetësuesi/ja vetëm e lehtëson procesin e komunikimit mes palëve dhe u ndihmon atyre që vetë të arrijnë deri tek zgjidhja që më pas shprehet përmes marrëveshjes për ndërmjetësim. Në Republikën e Kosovës, sipas regjistrimit të fundit të vitit 2017 të MD-së, janë të trajnuar dhe licencuar që të ndërmjetësojnë njëqind e tetëdhjetë e nëntë (189) ndërmjetësues/e për të ofruar shërbime të ndërmjetësimit në tërë territorin. Diku shtatëmbëdhjetë (17) e tyre vijnë apo ju përkasin komuniteteve jo-shumicë.

Përmes procedurës së ndërmjetësimit në Kosovë mund të adresohen kontestet apo mosmarrëveshjet nga fusha civile përfshirë ajo tregtare, familjare, të punës, pronësore dhe të tjera civile, fusha administrative dhe ajo penale.<sup>22</sup> Procedura e ndërmjetësimit në fushën penale mund të aplikohet në rastet ku sipas ligjit përkatës parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vite.<sup>23</sup> Në të gjitha rastet mund të shfrytëzohet në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës, prokurorisë apo e një organi tjetër kompetent.<sup>24</sup> Ajo nuk zbatohet për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.<sup>25</sup>

Që nga funksionalizimi i tij, ndërmjetësimi në Kosovë ka pasur shumë efekte pozitive në qasjen e qytetarëve në drejtësi. Nëse i referohemi numrit të kontesteve apo mosmarrëveshjeve që janë trajtuar në procedurën e ndërmjetësimit, janë shifra shumë shpresëdhënëse për të ardhmen e ndërmjetësimit në vend. Numri i rasteve të trajtuara dhe zgjidhura në procedurën e ndërmjetësimit, nga viti në vit ka pasur rritje dhe avancim. Andaj ky mekanizëm i sistemit të drejtësisë është me rëndësi të veçantë sa i përket qasjes së qytetarëve të Kosovës në drejtësi.<sup>26</sup>

## 10.2. Qasja në procedurën e ndërmjetësimit

Një kontest apo mosmarrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit mund të iniciohet nga vetë palët (ndërmjetësimi me vetë-referim), gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ.<sup>27</sup> Kështu, palët mund të pajtohen që para se të fillojnë çfarëdo procedure në lidhje me kontestin apo mosmarrëveshjen e tyre, të provojnë procedurën e ndërmjetësimit për zgjidhjen e saj. Procedura e ndërmjetësimit po ashtu fillohet kur për një rast që gjendet në gjykatë, prokurori apo në organin

<sup>21</sup> Ligji Nr 06/L-009 për Ndërmjetësim 2018, neni 3.1.4.

<sup>22</sup> Po aty, neni 2.1.


<sup>23</sup> Po aty, neni 2.2.

<sup>24</sup> Po aty, neni 2.3.

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Rrustem Qehaja dhe Isuf Jahmurataj, 'Ndërmjetësimi një segment i rëndësishëm i sistemit juridik të Kosovës për zgjidhjen alternative të kontesteve civile' (2018) 14 AUDJ 1.

<sup>27</sup> Ligji Nr 06/L-009 për Ndërmjetësim 2018, neni 8.1.



kompetent administrativ dhe palët pajtohen që të ndjekin procedurën e ndërmjetësimit atëherë gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ informon dhe udhëzon palët dhe referon rastin në procedurë të ndërmjetësimit.<sup>28</sup>

Procedura e ndërmjetësimit mund të iniciohet dhe zhvillohet vetëm nëse ekziston vullneti i lirë dhe i plotë i të gjitha palëve të përfshira, në të kundërtën nuk mund të shfrytëzohet.<sup>29</sup> Po e njëjta vlen edhe për përzgjidhjen e ndërmjetësuesit dhe rezultatin e procedurës së ndërmjetësimit, që mund të jetë i suksesshëm (me arritje të marrëveshjes të ndërmjetësimit në formë të shkruar) apo i pasuksesshëm. Përveç, vullnetit të plotë të palëve, procedura e ndërmjetësimit është e bazuar dhe në parimet e barazisë së palëve në procedurë, paanshmërinë dhe pavarësinë e ndërmjetësuesit/es dhe privatësinë dhe konfidencialitetin e procedurës.<sup>30</sup>

Në aspekt të kostos së procedurës së ndërmjetësimit, palët që hyjnë në të, në parim kanë vetëm përgjegjësinë që të kompensojnë ndërmjetësuesin/en e rastit të tyre në pajtim me Udhëzimin Administrativ MD – Nr. 04/2021 për Tarifën e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës.

Ndërmjetësimi në Republikën e Kosovës mund të jetë edhe i detyrueshëm; i detyrueshëm e ka kuptimin vetëm sa i përket obligimit që për një numër të definuar (me ligj) të kontesteve, gjykata informon dhe detyron palët që të provojnë procedurën e ndërmjetësimit.<sup>31</sup> Ky obligim vlen vetëm për provimin e procedurës së ndërmjetësimit, por jo për arritjen e një zgjidhje apo marrëveshje.<sup>32</sup>

Procedura e ndërmjetësimit mund të përfundojë me:

- ⇒ marrëveshje për zgjidhjen e ndërmjetësuar;
- ⇒ tërheqjen e njëres apo të gjithë palëve të përfshira nga procedura;
- ⇒ konfirmim të ndërmjetësuesit/es të rastit të caktuar, pas konsultimit me palët e rastit në fjalë, se vazhdimi i procedurës nuk është i arsyeshëm;
- ⇒ me kalim të afateve ligjore të procedurës së ndërmjetësimit.<sup>33</sup>

Marrëveshjet e arritura në procedurën e ndërmjetësimit, të cilat janë me shkrim, kanë efekt juridik apo fuqi të dokumentit përmbarues (e aplikueshme në rastet e ndërmjetësimit me vetë-inicim të palëve, të referuar nga gjykata, të referuar nga organi kompetent administrativ).<sup>34</sup> Ato raste që janë të referuara nga prokuroria, dhe zgjidhen me marrëveshje të ndërmjetësimit, pas dorëzimit të kësaj të

---

<sup>28</sup> Po aty, neni 8.2.

<sup>29</sup> Po aty, neni 4.

<sup>30</sup> Po aty, nenet 5, 6 dhe 7.

<sup>31</sup> Po aty, neni 9.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Po aty, neni 17.

<sup>34</sup> Po aty, neni 15.1., 15.3. dhe 15.4.



fundit në prokurori dhe më pas aprovimit nga e kryeprokurorit/es së prokurorisë përkatëse, e kanë fuqinë e vendimit të formës së prerë.<sup>35</sup>

Procedura e ndërmjetësimit është mundësi e mirë e zgjidhjeve të kontesteve apo mosmarrëveshjeve jashtë rrugëve gjyqësore dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit, ka efekte juridike të plotëfuqishme për palët; sa i përket mënyrës dhe formës së zgjidhjes së kontestit apo mosmarrëveshjes, marrëveshja e ndërmjetësimit është e barazvlefshme me *aktgjykimin* e gjykatës. Ka shumë benefite, si mundësimi i qasjes në drejtësi në kohë të shkurtër, kosto të ulët, me fleksibilitet të procesit si dhe ofrimin e "kontrollimit" të procedurës dhe rezultatit të tij nga ana e palëve. Po ashtu, në rastet penale, mundëson që me zgjidhjen e tyre, të shmanget evidentimi apo regjistrimi i palës në regjistrat penal.

Shërbimet e ndërmjetësimit për rastet me vetë-inicim referohen apo mund të qasen/kërkohen në mënyrë të drejtpërdrejte nga ana e ndërmjetësuesve të licencuar të vendit. Shërbimet e ndërmjetësimit për rastet që gjenden dhe referohen nga gjykata dhe prokuroria administrohen nga zyrat e ndërmjetësimit pranë secilës Gjykatë Themelore dhe Prokurori Themelore në Kosovë dhe ndërmjetësohen nga ndërmjetësuesit/et e licencuar.

Informata më të gjëra dhe më të plota për sistemin e ndërmjetësimit dhe ndërmjetësuesit mund të gjenden në:

- ⇒ website apo web platformën e ONDK-së të mundësuar nga ADRC - MCM dhe të mbështetur nga NED, [www.ndermjetesimi.com](http://www.ndermjetesimi.com) 
- ⇒ faqen zyrtare të MD-së, [md.rks-gov.net](http://md.rks-gov.net) 
- ⇒ web të ADRC – MCM, [www.mediation-mitrovica.org](http://www.mediation-mitrovica.org) 

## II. NOTERIA DHE QASJA NË DREJTËSI

---

**Shërbimi i noterisë** është shërbim publik, të cilin e ushtrojnë noterët e emëruar nga Ministri/ja i/e Drejtësisë sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Noterët duhet të jenë pavarur, të paanshëm dhe profesional në ushtrimin e shërbimit të noterisë në pajtim me kërkesat ligjore. Me qëllim të realizimit të të drejtave, qytetari në baza ditore mund t'i qaset shërbimit të noterisë; në këtë shërbim mund të realizojë të drejta pronësore, trashëgimore, qarkullim të pasurisë në aspektin ekonomik dhe juridik, autorizimin e personave tjerë që në emër dhe për llogari të tij/saj të realizojë aktivitete.

---

<sup>35</sup> Po aty, neni 15.2.



Në shërbimin e noterisë kanë qasje të gjithë. Ky shërbim kryen këto punë:

- ⇒ përpilon, vërteton dhe lëshon dokumente noteriale;
- ⇒ vërteton dokumentet noteriale të cilat janë hartuar nga pala apo një person i tretë;
- ⇒ pranon për ruajtje dokumente, para të gatshme, urdhërpagesa, çeqe, obligacione publike dhe letra me vlerë dhe sende tjera;
- ⇒ ndërmerr të gjitha veprimet në procedurë jokontestimore/trashëgimore, ku përfshihen por nuk kufizohet në përpilimin e testamentit noterial, shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe vendosjen me *aktvendim* për trashëgiminë në rastet jokontestimore, vlerësimet dhe shitjet publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshmërive në procedurën jokontestimore, ruajtjen e dokumenteve të trashëgimisë, të parave, letrave me vlerë apo sendeve të çmueshme, kryerjen e punëve të tjera të besuara me ligj të veçantë.


Dokumente noteriale janë:


- ⇒ *aktvendimi* për trashëgiminë jokontestimore;
- ⇒ dokumentet për punë juridike dhe për deklaratat të cilat i kanë përpiluar noterët (akti noterial);
- ⇒ dokumentet e përpiluara nga pala apo një person i tretë dhe të vërtetuara/solemnizuara nga noteri (vërtetim noterial);
- ⇒ procesverbalet për veprimet juridike të cilat i kanë kryer ose në të cilat kanë qenë të pranishëm noterët (procesverbalet noteriale);
- ⇒ vërtetimi i fakteve të cilat në kuadër të autorizimeve i vërteton noteri dhe vërtetimi i kopjeve, nënshkrimeve dhe shënimeve të tjera (vërtetimi noterial).

Kështu, shërbimi i noterisë, ndër të tjera, ka kompetencë që të vërtetoj kontrata të shitblerjes, qeras, hipotekës e kontratave tjera, vërtetimin e testamentit noterial, pranimin dhe ruajtjen e dokumenteve me vlerë dhe sendeve tjera, shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, etj. Të gjitha këto janë me rëndësi shumë të madhe për jetën e qytetarit, pasi një pjesë e këtyre shërbimeve janë të nevojshme në baza ditore.

Dokumentet e noterizuara gëzojnë supozimin e dyfishtë të ligjshmërisë. Ato mund të kontestohen vetëm përmes procedurave gjyqësore. Noteri/ja ka të drejtë në shpërblim për punën dhe në kompensim të shpenzimeve lidhur me punët e kryera në pajtim me tarifën për shpërblimet dhe kompensimet të përcaktuar me aktin përkatës nënligjor.

Shërbimi i noterisë është shumë i rëndësishëm pasi përmes tij mundësohet qasje në një sërë shërbime për qasje në drejtësi. P.sh., ky shërbim i mundëson qytetarit që sot shumë lehtë të realizojnë një kontratë të shitblerjes pa asnjë kufizim të shumës, vërtetojnë autorizim përmes së cilit përfaqësohen



në një aktivitet juridik për të cilin kanë interes, japin deklarata që kërkohen nga ana e disa institucioneve, si dhe të shqyrtojnë trashëgimin. Po ashtu lehtëson të bërit biznes. Shërbimet e noterisë mund të merren brenda ditës dhe kanë rëndësi për aktivitetin juridik të qytetarit dhe qasjes në drejtësi për shërbimet që mbulon noteria, si dhe zhvillimin e biznesit. Me qëllim të informimit mbi sistemin e noterisë dhe komunikimit potencial me noterët, mund të qaset në [www.noteria-ks.org](http://www.noteria-ks.org) 

## 12. PËRMBARIMI DHE QASJA NË DREJTËSI

---

Në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës hynë dhe **Sistemi i Përmbarimit Privat**. Është i rregulluar me legjislacionin përkatës në fuqi për fushën e përmbarimit dhe përfaqëson fazën e fundit të procedurës gjyqësore. I referohet zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe kontratave me qëllim të realizimit të të drejtave si procedurë e fundit përmbarimore. Kur këto dokumente nuk zbatohen vullnetarisht nga pala e ka ngarkuar me zbatim, pala e cila ka interes që të zbatohet njëri nga këto mund të kërkojë që këto të zbatohen nga përmbaruesi privat në Republikën e Kosovës. Kjo mundëson që pala të realizon të drejtën dhe duke e realizuar të drejtën kjo vlerë i referohet shtetit të së drejtës. Sistemi i Përmbarimit Privat në kuadër të sistemit juridik ka një rëndësi të veçantë dhe ofron shërbime të qasjes së qytetarëve të Kosovës në drejtësi dhe siguri juridike. Mundëson që njohja e një të drejte sipas legjislacionit përkatës në fuqi e materializuar në vendime gjyqësore dhe kontrata, të realizohet edhe në aspektin praktik.

Përmbarimi privat në Republikën e Kosovës është i rregulluar dhe përcaktohet me ligj. Organ përmbarues është përmbaruesi privat dhe gjykata. Përmbaruesi privat është i licencuar nga MD dhe ka në kompetencë që të zhvilloj procedurën e përmbarimit. Ndërsa, gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore vetëm lidhur me:

- ⇒ të gjitha çështjet nga e drejta familjare;
- ⇒ kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera.

Në procedurën e përmbarimit në Republikën e Kosovës, ekzekutohen:

- ⇒ vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbarues;
- ⇒ vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (ujdia);
- ⇒ dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me legjislacionin për noterinë;
- ⇒ marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me legjislacionin për ndërmjetësim pas aprovimit të gjykatës;



- ⇒ aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të gjykatave të huaja si dhe vendimet e gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarrim brenda territorit të vendit;
- ⇒ vendimet dhe marrëveshjet përmbarruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga gjykata;
- ⇒ kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;
- ⇒ vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarrues europian;
- ⇒ dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarrues.

Pala duke pasur njërin nga dokumentet e cekura më lartë, përgatit dhe propozimin për përmbarrim me të cilin iniciohet procedura e përmbarrimit dhe të njëjtin ja dorëzon përmbarruesit privat. Me të dorëzuar tek përmbarruesi privat, propozimin për përmbarrim dhe dokumentin përmbarrues, përmbarruesi privat fillon procedurën e përmbarrimit duke nxjerrë *Urdhërin për Përmbarrim* i cili është vendim i përmbarruesit privat me të cilin pranohet plotësisht apo pjesërisht propozimi për kryerjen e përmbarrimit. Pala kundër të cilës është inicuar procedura e përmbarrimit ka të drejtë që *Urdhërin Përmbarrimor* ta kundërshtoj përmes *Prapësimi*. *Prapësimi* dorëzohet tek përmbarruesi që ka nxjerr *urdhërin përmbarrimor* dhe *prapësimi* së bashku me *urdhërin përmbarrimor* si dhe me të gjitha shkresat tjera i dërgohet Gjykatës Themelore për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me *prapësimin*. Lidhur me *prapësimin*, gjykata vendos me vendim i cili nga palët në procedurën e përmbarrimit mund të ankimohet në gjykatën e shkallës së dytë, përkatësisht, atë të apelit përmes parashtrimit të *ankesës*.

Atë që e siguron legjislacioni përkatës në fuqi, përmbarrimi privat mundëson që të ekzekutohen dokumentet përmbarrimore të cekura më lartë dhe përmes tyre të realizohet e drejta nga palët. Kjo është një mundësi shumë e mirë për të cilën pala duhet të paguajë një kosto për këto shërbime të përcaktuar me aktin përkatës nënligjor për tarifën. Shërbimet e Përmbarrimit Privat janë në kohë të shpejtë dhe kosto financiare të arsyeshme. Qasja në drejtësi përmes Përmbarrimit Privat është njëra ndër të drejtat më të rëndësishme, ku ky sistem siguron mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe legjislacion përkatës në fuqi dhe kjo rrjedhimisht është njëri ndër mekanizmat e shtetit të së drejtës.

Mbi sistemin e përmbarrimit në Kosovë dhe përmbarruesit, të gjithë palët e interesuara mund të njoftohen përmes faqes zyrtare të OPK-së, [www.opk-rks.org](http://www.opk-rks.org) 





### GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Lagjja "Prishtina e Re" p.n. Pallati i Drejtësisë  
Prishtinë 10 000  
+383 (0) 38 200 173 88  
prishtine.gjyqesori-rks.org  
gjthprishtine@rks-gov.net

### GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Rr "Filipa Visnjica" p.n., Mitrovicë e veriut  
Rr "Mbretëresha Teutë" p.n., Mitrovicë e jugut  
Mitrovicë 40 000  
+383 (0) 200 177 31/32/40  
mitrovice.gjyqesori-rks.org  
gjthmitrovice@rks-gov.net

### GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Rr "Salih Çeku" p.n.  
Ferizaj 70 000  
+383 (0) 29 032 100 9 | +383 (0) 29 032 270 2  
ferizaj.gjyqesori-rks.org  
gjthferizaj@rks-gov.net

### GJYKATA THEMELORE GJILAN

Rr "Marie Shllaku" p.n.  
Gjilan 60 000  
+383 (0) 28 032 218 0  
gjilan.gjyqesori-rks.org  
gjthgjilan@rks-gov.net

### GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Rr "Bardhyl Qaushi" Nr 148  
Gjakovë 50 000  
+383 (0) 44 255 439 | +383 (0) 39 032 413 0  
gjakove.gjyqesori-rks.org  
gjthgjakove@rks-gov.net

### GJYKATA THEMELORE PEJË

Rr "Adem Jashari" p.n.  
Pejë 30 000  
+383 (0) 39 434 725  
peje.gjyqesori-rks.org  
gjthpeje@rks-gov.net

### GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Rr "Wiliam Woker" p.n.  
Prizren 20 000  
+383 (0) 29 222 125  
prizren.gjyqesori-rks.org  
gjthprizren@rks-gov.net



## **PROKURORIA THEMELORE PRISHTINË**

Lagjja "Prishtina e Re" p.n., Pallati i Drejtësisë  
Objekti C  
Prishtinë 10 000  
+383 (0) 38 200 18 711  
[www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)

## **PROKURORIA THEMELORE MITROVICË**

Lagjja e Boshnjakëve p.n., Mitrovicë e veriut  
Mitrovicë 40 000  
+383 (0) 38 200 662 01  
[www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)  
[pth.mitrovice@rks-psh.org](mailto:pth.mitrovice@rks-psh.org)

## **PROKURORIA THEMELORE FERIZAJ**

Rruga e Reqakut p.n.  
Ferizaj 70 000  
+383 (0) 29 032 163 3  
[www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)

## **PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË**

Rr "Nënë Terezë" p.n.  
Gjakovë 50 000  
[www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)

## **PROKURORIA THEMELORE GJILAN**

Rr "Marie Shllaku" p.n.  
Gjilan 50 000  
+383 (0) 28 032 028 2  
[www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)

## **PROKURORIA THEMELORE PEJË**

Rr "Hasan Cermahija" p.n.  
Pejë 30 000  
+383 (0) 39 422 163  
[www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)

## **PROKURORIA THEMELORE PRIZREN**

Rr "William Walker" p.n.  
Prizren 20 000  
+383 (0) 29 622 000  
[www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)



### **GJYKATA E APELIT**

Lagjja "Prishtina e Re" p.n., Pallati i Drejtësisë  
Objekti B  
Prishtinë 10 000  
+383 (0) 38 200 184 10  
apeli.gjyqesori-rks.org  
gjykataeapelit@rks-gov.net

### **GJYKATA SUPREME**

Lagjja "Prishtina e Re" p.n., Pallati i Drejtësisë  
Objekti B  
Prishtinë 10 000  
+383 (0) 38 200 187 75  
supreme.gjyqesori-rks.org  
gjykatasupreme@rks-gov.net

### **PROKURORIA E APELIT**

Lagjja "Prishtina e Re" p.n., Pallati i Drejtësisë  
Objekti C  
Prishtinë 10 000  
+383 (0) 38 200 188 67  
www.prokuroria-rks.org


### **ZYRA E KRYEPROKURORIT TË SHETIT**

Rr "Luan Haradinaj" p.n.  
Prishtinë 10 000  
+383 (0) 38 200 188 48  
www.prokuroria-rks.org



## 13. LISTA E BURIMEVE NË FORMË TË SHTOJCËS

---

Më poshtë është referuar korniza ligjore në bazë të së cilit është përpiluar dhe mbështetur ky manual, dhe i cili mund të qaset dhe sigurohet në gjuhët shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe angleze përmes Gazetës Zyrtare në [www.gzk.rks-gov.net](http://www.gzk.rks-gov.net) 

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Ligji Nr 06/L-054 për Gjykatat

Ligji Nr 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Ligji Nr 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Ligji Nr 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit

Ligji Nr 04/L-193 për Avokatinë

Ligji Nr 05/L-019 për Avokatin e Popullit

Ligji Nr 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas

Ligji Nr 06/L-009 për Ndërmjetësim

Ligji Nr 06/L-010 për Noterinë

Ligji Nr 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore

Kodi Nr 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës

Kodi Nr 04/L-123 i Procedurës Penale

Ligji Nr 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore

Ligji Nr 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve

Ligji Nr 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës

Ligji Nr 2004/26 për Trashëgiminë i Kosovës

Ligji Nr 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

